



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 15.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas dy kërkesës për ri-shqyrtim të datës 07.04.2024 të parashtuar nga Operatori Ekonomik **Raff II SH.P.K.** nga Prishtina, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi **206-23-14371-5-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si te pa bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **Raff II SH.P.K.** e datës 07.04.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi **206-23-14371-5-1-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK, të datës 02.04.2024 të publikuar ne platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi mbi Vendimin e AK, i datës 02.04.2024;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatorët Ekonomik **Raff II SH.P.K.** me datën 07.04.2024 ka parashtuar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK”** me nr. prokurimi 206-23-14371-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 15.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE ankues:

Neni 1 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 52 i LPP-së

Neni 56 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 68 i LPP-së

Neni 69 i LPP-së

Neni 72 i LPP-së

Neni 25 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik

Pretendimet ankimore

Me datën 02.04.2024 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë OE BM Group SHPK-Prishtinë me çmim prej:19,943.163.85 €, kurse ne jemi eliminuar me arsyetimin si në vijim:

- Nuk e kemi plotësuar Kërkesën 3. b) të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale
- Në kundërt të udhëheqësve është kërkuar Instalues gazi, OE e ka ofruar z. Nazmi Hoxha, i kualifikuar si teknik i ngrohjes, për kaldaja me avull dhe me ujë të ngrohtë.
- Te Aneksi I i DT është kërkuar që OE duhet të dorëzon me Ofertën e tij, "Planin Dinamik të Detajuar" duke plotësuar Formën Standarde të Planit Dinamik të publikuar si dokument shpese tek Dosja e Tenderit, max. 30 muaj. Planin Dinamik nuk e kemi plotësuar si duhet, jo ne mënyrë reale për punët inzhinierike.

Të dy arsyet e eliminimit janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme.

1. Sa i përket z. Nazmi Hoxha e ku thuhet se është i kualifikuar si teknik i ngrohjes, për kaldaja me avull dhe me ujë të ngrohtë, ndërsa është kërkuar instalues gazi, ju sqarojmë se i njëjti posedon kualifikimin për instalues gazi, mirëpo që me dosje të tenderit kjo certifikatë nuk është bashkangjitur për shkak të një lëshimi teknik. Prandaj

për të vërtetuar një dëshmi të tillë po ua bashkëngjisim certifikatën për instalues gazi.

Në lidhje me këtë mungesë të certifikatës, autoriteti kontraktues ka mundur të kërkojë sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, përderisa kanë qenë të bashkangjitura të gjitha dëshmitë e tjera të këtij personi.

2. Sa i përket arsyes së dytë të eliminimit në lidhje me planin dinamik, ju sqarojmë se ne e kemi plotësuar planin dinamik pikërisht ashtu siç është kërkuar.

Arsyeja e dhënë se është plotësuar në mënyrë joreale për punët inxhinierike, për neve është arsye abstrakte dhe plotësisht e paarsyeshme, pasi që nuk e kuptojmë se çka do të thotë në mënyrë joreale.

E rëndësishme është se plani dinamik është plotësuar dhe dorëzuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit, ndërsa nuk është kërkuar diçka tjetër të plotësohet në plan dinamik, prandaj kjo arsye është plotësisht e paqëndrueshme dhe imagjinare.

Tek specifikimet teknike është përcaktuar ndër të tjera si në vijim:

Afati kohor i planifikuar i përfundimit të tërësishëm të punimeve përfshirë pranimin e perkohshëm të punimeve dhe pranimit-dorëzimit të objektit duhet të jete jo me shume se 30 muaj kalendarik.

Edhe ne e kemi ofruar planin dinamik sipas kësaj kërkesë me planifikimin që punimet do të kryhen brenda 30 muajve. Edhe pse kërkesa për plan dinamik nuk ka qenë kërkesë e kualifikueshmërisë.

Neni 56.3 i LPP-së ndalon eliminimin për kërkesa që nuk janë pjesë e dosjes së tenderit, prandaj në këtë rast autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë.

Fillimisht ju sqarojmë se ne kemi pasur qasje në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe pas analizës që i kemi bërë dokumentacionit të të njëjtit operator ekonomik, kemi ardh në përfundim se ky OE është i papërgjegjshëm për arsyet si në vijim:

Sqarojmë se në nenin 8.1&8.2 të FDT-së është kërkuar si më poshtë:

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka kapital financiar për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje bankare- qasje të pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% të plotësohet nga lideri në rast të grupit).

Dëshmia 2. Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirologari ose qasje të pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës në vlerë prej së paku 4 milion Euro (min. 60% të plotësohet nga lideri në rast të grupit).

Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar (në rastin e kredisë së pakushtezuar OE duhet të paraqes dokumentin nga banka në emër të projektit).

1. OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një dokument nga Raiffeisen Bank me titullin **Letër mbështetje**, mirëpo që ky dokument nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit sepse askund nuk shkruan se ky OE ka mjete në llogari apo se ka **qasje të pakushtezuar** në kredi në vlerën 4 milion euro.

Në këtë letër shkruan se Banka është e hapur ta përkrah çdo kërkesë të klientit bazuar në kriteret dhe procedurat e brendshme të bankës për kreditim për këtë projekt.

Dokumente të tilla banka i lëshon secilit që kërkon letër mbështetje dhe e përkrah nëse i plotëson kushtet.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe një dokument tjetër nga BKT ku titulli është referencë për këtë projekt, ndërsa në brendi ndër të tjera shkruan:

" **BM GROUP SHPK** ", aktualisht është listat aktiv në bankën tonë me një limit të aprovuar prej 1,000,000 EUR dhe banka është e hapur të përkrah çdo kërkesë të tij bazuar në politikat e majes dhe menaxhimit të rishtat lidhur me rrethetjen financiare bazuar Referencat "Vazhdimi i Ndërtimit - Qendra e Mjebesise Emergjente ne QKUK Nr.Prakturimit 206-13-14371-517"

Edhe në këtë dokument askund nuk shkruan se OE i rekomanduar për kontratë ka mjete të gatshme në llogari, e as qasje në kredi të pakushtëzuar në vlerë prej 4 milion euro, prandaj ky OE nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, siç u cek më lartë.

Në nenin 9.1&9.2 të FDT-së është kërkuar:

Kërkesa 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka realizuar me sukses projekte te ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve te larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë. Ne rast te konsorciumit, së paku 60% e punëve te përfunduara kërkohe për liderin e grupit.

Së paku njëri projekt te jetë spitalor me vlerë të madhe (kërkohe për liderin ne rast te grupit), ku të jenë kryer punime lidhur me X-ray, Gaz medicinal, ventilim, klimatizim, dyer X-ray Automatike, etj.

Nuk pranohen objektet individuale, ambulanta, projekte rrugore, ura, ujësjellës, kanalizime, e te ngjashme.

Dëshmia 2.

- Një Listë të projekteve të realizuara - Original e vulosur dhe e nënshkruar.
Lista duhet t'i ketë këto te dhëna

- Titulli i kontratës,

- Investitori,

- Të dhënat e personit kontaktues, - Datën e fillimit dhe te përfundimit të projektit,

- Vlerën e projektit. Konsiderohen të vlefshme vetëm listat me të dhënat e lartcekura.

Për çdo projekt te realizuar kërkohe Referencë ose Procesverbal i Pranimit teknik (për investitor privat AK mund t'i verifikoj transaksionet financiare).

2. OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kërkesë për arsyet si në vijim:

➤ Ka ofruar një referencë të lëshuar nga **Bau Holding L.L.C** në vlerë prej 1,435,818.68 €, e ku shënohet se ka përfunduar pjesërisht ndërtimin e stadionit të Gjilanit.

Kjo referencë është dashur të verifikohet se a janë kryer punë të ndërtimit apo janë bërë vetëm furnizime me beton apo diçka tjetër. Verifikimi është dashur të bëhet edhe përmes

transaksioneve bankare, pasi që kërkesë e dosjes ka qenë që “për investitor privat AK mund t’i verifikoj transaksionet financiare.

- Ka ofruar një referencë nga **Parking Center** në vlerë prej 1,313,564.01 €, e ku shënohet se kanë nënshkruar kontratë për ekzekutimin e punimeve (furnizim dhe punë).

Kjo referencë është dashur të verifikohet se a janë kryer punë të ndërtimit apo janë bërë vetëm furnizime me beton apo diçka tjetër. Verifikimi është dashur të bëhet edhe përmes transaksioneve bankare, pasi që kërkesë e dosjes ka qenë që “për investitor privat AK mund t’i verifikoj transaksionet financiare.

- Ka ofruar një referencë nga **Pozhegu Brothers** në vlerë prej 535,694.00 €, e ku shënohet se me sukses pjesërisht ka përfunduar furnizimin me beton për ndërtimin e objektit afarist banesor Garden Building-C5 dhe Sofali.

Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, sepse ka të bëjë me furnizime. Kjo vërtetohet edhe tek kontrata e prezantuar ndërmjet tyre.

- Ka ofruar një referencë nga **Ip Kos SHPK** në vlerë prej 624,107.21 €, e ku shënohet se ka përfunduar furnizimin me beton dhe punimin e pompës.

Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, sepse ka të bëjë me furnizime.

- Ka ofruar një referencë nga **Britania Homes SHPK** në vlerë prej 922,353.22 €, e ku shënohet se ka përfunduar me sukses furnizimin dhe për ndërtimin e objekteve në lagjen Britania Homes.

Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit sepse ka të bëjë me furnizime

- Ka ofruar një referencë nga **Marigona Hill SHPK** në vlerë prej 838,593.00 €, e ku shënohet se ka përfunduar me sukses furnizimin dhe për ndërtimin e objekteve në lagjen Britania Homes.

Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, sepse ka të bëjë me furnizime

- Ka ofruar një referencë nga **Mada Group SHPK** në vlerë prej 4,364,743.74 €, e ku shënohet se ka përfunduar me sukses furnizimin dhe për ndërtimin e objekteve në lagjen MARIGONA Hill.

Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, sepse ka të bëjë me furnizime.

- Ka ofruar një referencë nga **Bau Holding LLC** në vlerë prej 6,268,653.31 € për punime në parkun industrial, mirëpo kjo kontratë duhet të verifikohet se a është realizu për ndërtim të lartë dhe kjo duhet të bëhet duke analizuar transaksionet se a janë bërë pagesat dhe nëse ka pagesa, a janë bërë për ndërtim të lartë apo për furnizime. Kontrata e nënshkruar ceket se ka të bëjë me furnizimin dhe kryerjen e punimeve.

Kjo referencë nuk duhet të merret parasysh.

- Ka ofruar një referencë nga **R&Rukolli SHPK** në vlerë prej 637,475.00 €, e ku shënohet se ka përfunduar punë si: instalime elektrike dhe nxemje qendrore.

Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes sepse ka të bëjë me punë elektrike, kjo vërtetohet edhe nga kontrata e prezantuar.

- Ka ofruar një referencë nga **Viva Fresh Store** në vlerë prej 1,044,995.15 €, e ku nuk përputhet përshkrimi i bërë tek referenca me atë tek kontrata, sepse në kontratë titulli është kontratë për furnizim dhe shërbime.

Kjo referencë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Edhe kontratat me UNOPS nuk janë shumë të qarta, prandaj kërkojmë që të verifikohen se a kanë të bëjnë me ndërtim të lartë, sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Të gjitha kontratat e cekura nuk mund të merren parasysh, sepse për disa po është shumë e qartë se kanë të bëjnë me furnizime, ndërsa për disa të tjera ku nuk janë qartësuar të dhënat, të paktën është dashur të verifikohen se a kanë të bëjnë me ndërtim të lartë dhe a ekzistojnë transaksionet ndërmjet tyre për ndërtim të lartë.

Nëse analizohet në detaje, lista e kontratave të OE të rekomanduara për kontratë dhe referencat për punë sipas kërkesave të dosjes së tenderit, rezulton se ky OE i ka 12,915.0006.20 € punë sipas kërkesës së dosjes së tenderit, prandaj është i papërgjegjshëm

Autoriteti kontraktues është dashur të shfrytëzojë nenin 52.7 të LPP-së për të bërë një kontrollim efektiv të informatave dhe dokumenteve të OE të rekomanduara për kontratë për kontratat të cilat nuk janë shumë të qarta, edhe pse në asnjë variant ky OE nuk e plotëson kërkesën për të dëshmuar vlerën e kontratave në vlerë prej së paku 25 milion euro.

Për OE e mëposhtëm që janë me çmim më të lirë se sa oferta jonë, konstatojmë se janë të papërgjegjshëm dhe arsyet e eliminimit nga AK, janë edhe pretendime tona ankimore, prandaj për të mos i përsëritur vetëm po i vendosim arsyet siç i ka dhënë autoriteti kontraktues.

OE "Ada Consulting Group SHPK&Architecture SHPK&Vllëzërit Asllani SHPK&Progen SHPK është i papërgjegjshëm me arsyet edhe të cilat i ka dhënë autoriteti kontraktues:

- Nuk e keni plotësuar Kërkesën 2 të Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare - Garancioni i ofruar është me kushtëzim nëse e fiton projektin do të shqyrtohet përkrhja financiare deri në 4 mil, jo siç është kërkuar i Pakushtëzuar.
- Nuk e keni plotësuar Kërkesën 2 të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale - Nuk ka dëshmuar punë të kryera për dyer X-ray Automatike. Lidhur me punimet me X-ray të Klinikës së Ortopedisë, për këtë projekt mungon pranimi teknik.
- Nuk e keni plotësuar Kërkesën 4.10 të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale - Mungon Certifikata për ekspertin e sigurisë dhe shëndetit në punë, z. Ahmet Morina. E ka prezantuar një Vendim nga MFPT, por jo certifikatën siç është kërkuar.

OE "Standard Beton SHPK&Arifaj SHPK&Liv Global Yapi Insaat Taahhut ve Ticaret Limited Sirketi" është i papërgjegjshëm me arsyet edhe të cilat i ka dhënë autoriteti kontraktues:

- Nuk e keni ofruar Deklaratën në betim për liderin e konsorciumit Liv Global Yapi İnşaat Taahhüt ve Ticaret Limited Şirketi.
- Nuk e keni plotësuar si duhet Marrëveshjen e Konsorciumit - Nuk i keni plotësuar 3 kushtet e marrëveshjes për liderin e konsorciumit Liv Global Yapi İnşaat Taahhüt ve Ticaret Limited Şirketi.
- Nuk e keni plotësuar Kërkesën 2 të Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare - E ka ofruar një Deklaratë nga BKT Shqipëri e datës 13.07.2023 që Arifaj ka kredituar 36,415,552 lek, por pa të dhëna të projektit. E ka ofruar edhe një konfirmim nga Credins Bank Shqipëri e dt. 24.11.2023 që Arifaj posedon në llogari 376,000.00 euro.
- Nuk e keni plotësuar Kërkesën 1 të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, për ISO certifikatat e kërkuara. Vetëm Standard Beton i posedon të gjitha ISO-te. Arifaj posedon vetëm ISO 9001. E ka ofruar ISO 9001:2015 turke me afat të skaduar 15.08.2023 e cila nuk i përket kompanisë Liv Global por një prodhuesi të paneleve elektrik BASKENT ELEKTRIK TABLO..., si dhe ISO 14001:2015 turke e cila nuk i përket kompanisë Liv Global por një prodhuesi të paneleve elektrik BASKENT ELEKTRIK TABLO...
- Te Aneksi 1 i DT është kërkuar që OE duhet të dorëzon me Ofertën e tij "Planin Dinamik të Detajuar" duke plotësuar Formën Standarde të Planit Dinamik të publikuar si dokument shtese tek Dosja e Tenderit, max. 30 muaj. Planin Dinamik e keni ofruar te pa plotësuar.

Këto arsye të eliminimit janë edhe pretendime tona ankimore.

OE "Teskon Proses Degerli Madenlar Finansal Danismanlik Tic LTD St&Fidola SHPK&Barbaros Mh Alzambak Sk Varyap Meridian Grand Tower është i papërgjegjshëm me arsyet edhe të cilat i ka dhënë autoriteti kontraktues:

- Kontratat e punëtorëve nuk e plotësojnë kërkesën e DT. Paga mujore e punëtorëve (e njëjta është edhe për mjeshtrin) sipas Nenit 8 të kontratës 200 € që bie ndesh me Ligjin për pagën minimale në RK.
- Kontrata për Valmir Koskoviku me emër të projektit, është e nënshkruar me 01.01.2016 ndërsa aktiviteti është shpallur në 2024.
- Kontrata për Bedri Koskoviku, me emër të projektit, është e nënshkruar me 01.01.2016 ndërsa aktiviteti është shpallur në 2024.

Këto arsye të eliminimit janë edhe pretendime tona ankimore.

Kërkesa 4. Staf i profesional – Inxhinierët

Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se posedon me staf profesional të nevojshëm (min. 10 inxhinierë) për realizimin e projektit.


Dëshmia 4.

- Lista e stafit profesional - original e nënshkruar dhe vulosur.

3. OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar këtë kërkesë sepse ka ofruar 9 inxhinier e jo 10 sa janë kërkuar. Kjo dëshmohet nga lista e stafit me inxhinier që e ka dorëzuar OE i rekomanduar për kontratë:

“BM Group” Sh.p.k
Lista e stafit me Inxhinier që do jenë pjesë projekti

NR.	Emri Mbiemri	Pozita	Profesioni	Ekperienca vite
1	Ilir Meleqi	Menaxher i projektit	Inxhinier i diplomuar i Nderimtarise-Drejtimi Konstruktive	20
2	Hallim Bajramaj	Menaxher i punishtes/operatives	Inxhinier i diplomuar i Nderimtarise-Drejtimi Konstruktive	21
3	Arben Meha	Inxhinier i Arkitekturës	Inxhinier i diplomuar i Nderimtarise-Drejtimi Arkitekturë	20
4	Sahit Hasani	Inxhinier i Nderimtarise-Konstruktive	Inxhinier i diplomuar i Nderimtarise-Drejtimi Konstruktive	21
5	Muhedin Morina	Inxhinier i Nderimtarise-Hidroteknike	Inxhinier i diplomuar i Nderimtarise-Drejtimi Hidroteknike	10
6	Florim Sytlejmani	Inxhinier i Elektroteknikes	Inxhinier i diplomuar i Nderimtarise-Drejtimi Konstruktive	22
7	Rexhep Leku	Inxhinier i Makinerise	Inxhinier i Diplomuar i Makinerise	18
8	Fatos Gashi	Gjeodet i Licencuar	Master i diplomuar i Gjeodezise	10
9	Muhamet Hamiti	Ekspert per siguri dhe shendet ne pune	Ekspert per siguri dhe shendet ne pune	5



Nuk ka ofruar dëshmi edhe për një inxhinier të elektroteknikes, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm, duke e favorizuar të njëjtin edhe pse nuk ka ofertuar konform kërkesave të dosjes së tenderit.

Udhëheqja e kësaj procedure të prokurimit nuk është bërë siç parashihet në nenin 56 të LPP-së, e po ashtu as sipas nenit 25 të rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, e cila përcakton si në vijim:

25.1 Sipas Nenit 56 të LPP, një OE do të konsiderohet i kualifikuar për pjesëmarrje në aktivitet të prokurimit nëse:

- a. Një OE vërteton të jetë i përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues dhe
- b. Një OE i tillë, në rast që AK ka përcaktuar kërkesa minimale për kualifikim, përmbush kërkesat e tilla dhe e dëshmon atë duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues në përputhshmëri me nenet 64 deri në 69 të LPP-së.

25.4 Kriteret e përshtatshmërisë” dhe “kërkesat minimale të kualifikimit” së bashku karakterizohen si “Kritere të Përzgjedhjes”. Kriteret e Përzgjedhjes janë kërkesa që një OE duhet të përmbushë për të konsideruar i kualifikuar për dhënie të kontratës publike.

Pra OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kriteret e përzgjedhjes dhe në këtë rast tenderi i tij nuk mund të kalojë në vlerësim të mëtutjeshëm dhe nuk mund të shpallet fitues.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm sipas neni 60 paragrafi 1.2 i LPP-së.**

Nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse nuk janë trajtuar të gjithë operatorët ekonomik njëjtë por është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë, ndërsa paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore, sepse ne jemi diskriminuar në këtë rast sepse është dashur të shpallemi fitues të kësaj kontrate.*

Gjithashtu paragrafi 6 i kësaj dispozite, pika (vi) shkruan qartë, citojmë *“që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse”*. Ndërsa në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm dhe oferta e tij nuk përputhet me kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet të cilat u cekën më lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrni:

VENDIM

- I. **APROVOHET**, e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE 4 A-M&Raf II SHPK
- II. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RISHQYRTIM** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Përgjigja e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me pretendimet Ankimore te OE ankues:

Ankesa juaj është administrativisht e pa pranueshme, duke marre parasysh se është adresuar nga Raff II SH.P.K. si anëtar i konsorciumit, ndërkohe qe bazuar ne marrëveshjen për themelimin e grupit është grupit – Konsorciumit, Lider i grupit është kompania 4 A-M.

MARRËVESHJE PËR THEMELIMIN E GRUPIT - KONZORCIUMIT

(nësi 711 LPP-se lidhur me mesin 24 te RBPP-48)

Për ka-operim në pjesëmarrje të përbashkët për realizime të projekteve në infrastrukturë, ndërtime riparime gjithashtu pjesëmarrje për zhvillimin e projekteve profesionale hulumtuese e shkencore, asistencës teknike në përpilimin e projekteve, elaboratave, simpoziumeve dhe shërbimeve të tjera nga fusha veprimtaria e ndërtimit të lartë, etj.

Marrëveshja është përpiluar në Prishtinë më 20.02.2024 në mes:

I - 4A-M sh.p.k	Nipi,	K92005016L - Lideri
II - Rafii sh.p.k	NUI,	810393083 - Anetar

Për tenderin e shpallur nga:

Autoriteti Kontraktues: **MINISTRIA E SHENDETESIS**

Titulli i AP-se: **VAZHDIMI I NDERTIMIT-QENDRA E MIEKESSES EMERGJENTE NE QKUK"**

Nr. i Prokurimit : 206-23-14371-5-1-1

Këtu e tutje partnerët:

Partnerët kanë vendosur të bashkëpunojnë me qëllim të ngritjes së mundësive respektivisht për mbështetje profesionale dhe shkencore, asistence teknike etj, për palët e treta.

Partnerët pajtohen që "4A-M" sh.p.k do të udhëheqë këtë partneritet dhe përfaqëson partneritetin te palët e treta si përfaqësues përgjegjës. Partneriteti do të ketë përgjegjësi të përbashkët për përgatitje profesionale dhe mbështetje shkencore ashtu si kërkon kontraktuesi respektivisht pala e treta.

Ardit Metallaj - Drejtor ligjor
"4A-M" sh.p.k

Haxhi Bytyqi - Drejtor ligjor
"Rafii" sh.p.k



Sa i përket pretendimit per arsyen e eliminimit se per z, Nazmi Hoxha si teknik i ngrohjes per kaldaja me avull ndërsa është kerkuar Instalues gazi, nuk pajtohem me kete pretendim, meqense kjo nuk ka qene mungese e vetme ne oferten tuaj dhe nuk ka qene arsya e vetme per eliminim, andaj AK nuk e ka pare te nevojshme te kerkohen sqarime shtese siç keni pretenduar, se nuk e keni bashkangjitur certifikaten per shkak te nje leshimi teknik.

Sa i përket pretendimit per arsyen e eliminimit se **Planin Dinamik nuk e keni plotësuar si duhet**, nuk pajtohem me kete pretendim, duke marre parasysh se ne Aneksin 1 te DT ne menyre te qarte është kerkuar:

OE duhet te dorëzon me Ofertën e tij, "Planin Dinamik të Detajuar" duke plotësuar Formën Standarde te Planit Dinamik te publikuar si dokument shtese tek Dosja e Tenderit.

Për secilin pozicion të përshkruar në paramasë duhet të shënohet numri i ditëve të nevojshme për përfundimin e pozicionit të caktuar. Plani dinamik duhet te jete konform normave dhe standardeve ndërtimore.

Shume nga pozicionet e paramases jane vendosur me Plan Dinamik pa nderprerje dhe pa nderlidhje mes vete, vetem si vija per komplet periudhen, p.sh. te Instalimet Elektrike - **Tokezimi dhe Rrufepritesi** fillon ne fillim me 30 maj 2024 dhe perfundon me 26 gusht 2026. Si ka mundesi qe ky pozicion te zgjase pa nderprerje per 27 muaj?!

Sa i perket pretendimit se OE I rekomanduar nuk e ka plotësuar kerkesen per mbeshtetje bankare 4 milion euro, nuk pajtohem me kete pretendim, duke marre parasysh se OE i rekomanduar ka deshmuar mbeshtetje bankare te pa kushtezuar (limit te aprovuar 3.4 + 3 mil euro) ne total prej 6.4 milion euro, shih deshmite:

Theksojme se kopmania BM Group shpk, me nr. identifikues 810839251 është klient i bankës tonë Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.

Kemi diskutuar qellimin e kompanise ne fjale per mbeshtetje financiare sipas references "Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK", nr. i prokurimit 206-23-14371-5-1-1.

BM Group shpk, aktualisht është klient aktiv ne banken tone me nje limit te aprovuar prej EUR3,400,000.00 dhe banka është e hapur te perkrah cdo kerkese te klientit bazuar ne kriteret dhe procedurat e brendshme te bankes per kreditim per projektin: "Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK", nr. i prokurimit 206-23-14371-5-1-1.

Deshirojme t'ju informojme se banka merr në konsideratë me interes të veçant cdo kerkese financiare që lidhet me qëllimin e përmendur më lartë.

Theksojmë se Kompania "BM GROUP SHPK", me numër identifikues 810839251, me pronar **Bedri Gilareva**, është klient i bankës tonë. Kemi diskutuar qëllimin e Kompanise ne fjale për mbeshtetje financiare sipas References: "Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK Nr.Prokurimit 206-23-14371-5-1-1"

" **BM GROUP SHPK** ", aktualisht është klient aktiv në bankën tonë me një limit te aprovuar prej 3,000,000 EUR dhe banka është e hapur të perkrah çdo kërkesë te tij bazuar ne politikat e matjes dhe menaxhimit te riskut lidhur me meshtetjen financiare bazuar Referencen "Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e Mjekësisë Emergjente ne QKUK Nr.Prokurimit 206-23-14371-5-1-1"

Sa i perket pretendimit se OE i rekomanduar nuk e ka plotesuar kriterin rreth puneve te kryera ne projekte te ngjashme- ndërtim ose renovim i objekteve te larta, në vlerë të përgjithshme jo me pak se 25 Milion Euro, gjatë periudhës se shkuar tre vjeçare deri në Njoftimin për Kontratë, nuk pajtohem me kete pretendim, duke marre parasysh se OE i rekomanduar ka prezantuar Listen e projekteve ne total 30,901,003.51 euro, ku vetem me UNOPS i ka mbi 4.7 milion euro, mbi 6.2 milion euro ne Punimet ne Parkun Industrial ne Miradi, mbi 4.3 milion ne lagjen Marigona Hill, mbi 3.3 milion ne qendren Park Plaza Podujeve, mbi 1.3 milion euro ne parkingun e Prishtines, mbi 1.7 milion ne stadiumin e qytetit te Drenasit, etj.

Ju rikujtojme se permes Sqarimeve shtese te publikuara me daten 05.02.2024 eshte lehtesuar ky kriter, ku eshte specifikuar se **"1. Pranohen edhe investimet private (si investime ne ndërtim te ndërtesave afaristo banesore). Pranohen objektet individuale, pranohen ambulatat."**

Sa i perket pretendimit per verifikim te transakcioneve bankare, kjo ka qene kjarte e specifikuar se "mund ti verifikoj" e jo "do ti verifikoj" - **(për investitor privat AK mund t'i verifikoj transakcionet financiare).**

Gjate vleresimit te ketij aktiviteti AK ka pasur parasysh nenin 1 te LPP-se Qellimin e aktivitetit per realizimin e projektit, duke e rekomanduar per kontrate OE sipas Kriterit te dhenies se kontrates Oferta Ekonomikisht me e favorshme, ku nese perlogariten Çmimi me i lire 90% dhe Garancioni I puneve te kryera 7 vite 10%, atehere oferta e rekomanduar eshte fituese edhe sikur te gjitha ofertat te ishin te pergjeggjshme.

Mangësitë e vogla ne ofertën e OE te rekomanduar i konsiderojmë si devijime te vogla, konform nenit 59.4 te LPP-se.


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit te këtij vendimi.**

Vendimi i dorëzohet:

1. Raff II SH.P.K.
2. Operatoreve ekonomik te interesuar



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit